



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 21.05.2025

Numër Protokoli : 3336/2025

A.nr.661/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.661/2025, të datës 15.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.T. kundër organit të punësimit Thesarit të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.661/2025, e datës 15.04.2025, e parashtruar nga ankuesi A.T. kështu që, **detyrohet** Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj kërkesën e datës 24.01.2025 të parashtruar nga ankuesi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra si në pikën I të dispozitivit.

A r s y e t i m

Ankuesi A.T. (tutje ankuesi) më datë 15.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative ndaj kërkesës së datës 24.01.2025 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2492/2025 të datës 15.04.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për korrigjim të koeficientit e datës 24.01.2025 nga ankuesin për zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit dhe emailin e datës 24.01.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se rastin e ankuesit, lënda kthehet në detyrim për vendosje, **sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi më datë 24.01.2025 ka parashtruar kërkesë për korrigjim të koeficientit tek zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, duke kërkuar që pas klasifikimit të Sistemit të Pagave si sistem shtetëror i informacionit dhe komunikimit me rendësi strategjike çështja

e tij të adresohet tek Komisioni për vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, mirëpo që nuk ka marr përgjigje.

Ankuesi kundër heshtjes administrative, ka parashtruar ankesë me pretendimet që të detyrohet zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës që kërkesën e tij ta adresoj tek Komisioni për vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike si organ përkatës.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të çështjes ankimore, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesën e datës 24.01.2025 të parashtruar nga ankuesi.*

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se lidhur me vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rendësi strategjike, është miratuar edhe akti nënligjor gjegjësisht Rregullorja (QRK) Nr. 22/2024 për Ekspertët, respektivisht me nenin 5 paragrafi 1, përcaktohet: *1. Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit i cili vlerëson se institucioni është pronar, menaxhon dhe administron sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rendësi strategjike, ose koordinon funksionimin e këtyre sistemeve, parashtron kërkesë për vlerësim të sistemit tek Komisioni, ndërsa përgjegjësit tjera janë të komisionit përkatës.*

Kështu që thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.661/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A. T.;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve
Njerëzore në Thesarin e Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.